



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:231401

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05439308

P.nr.768/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Albinë Velekinca Sadiku, në çështjen penale kundër të pandehurit A. Q. nga Gjilani, për shkak se ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 paragrafi 4 me paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-ës), të cilin e mbron sipas detyrës zyrtare av.H. A. nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilani-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr...../2023, të datës 30 10.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar të datës 15.02.2024, mori dhe shpalli , ndërsa me datë 12.03.2024, përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri A. Q., nga babai M. dhe nëna A., e lindur I., i lindur më datë, në Gjilani, ku edhe jeton në rr.“Q. B.”,(dh. i b.), nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punon si kamarier, i gjendjes së varfër ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 13.10.2023, rreth orës 14.20h, në Gjilani, në rr.“Halim Orana”, i pandehuri, me dashje dhe me qëllim të shkaktimit të frikës, ankthit dhe pasigurisë për jetë ka kanosur seriozisht të dëmtuarin E. I., me fjalë dhe veprime konkludente përmes një mjeti të rrezikshëm – brisku, në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje ditë më parë rreth marrjes së përparësisë në trafik, më dt.13.10.2023 i pandehuri sapo e vëren të dëmtuarin E., në rrugë, nxjerr briskun të cilin e hap dhe e afron tek fyti i tij, duke e kërcënuar me veprime konkludente se do ta presë, e më pas edhe e kanos me fjalët “shihemi na ma vonë”, me ç’rast me veprimet dhe fjalët e tija tek i dëmtuari ka shkaktuar frikë, ankth dhe pasiguri për jetë.

-Me çka ka kryer veprën penale kanosja nga neni 181 par.4 lidhur me par. 2 të KPRK-ës.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,42,43,44,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës, të pandehurin :

E GJYKON

I.Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej **6 (gjashtë) muaj**, ashtu që me propozimin dhe me pëlqimin e të pandehurit dhe në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, të pandehurit A. Q., dënimi i shqiptuar me burgim i **ZËVENDËSOHET** me dënim me gjobë në shumën prej **400.00€ (katërqind-euro)**, të cilën gjobë i njëjti është i obliguar ta paguajë me **tri këste** në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri i larte cekur, nuk dëshiron ose nuk mundet ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që 1 (një) ditë burgim do t'i llogaritet për çdo 20 euro, të dënimit me gjobë.

Në bazë të nenit 276 paragrafit 3 dhe 4 të KPRK-ës, nga i pandehuri **KONFISKOHET**, një brisik i zi, me teh 7 cm, si provë dhe mjet i kryerjes së veprës penale.

I dëmtuari **E. I., rr."F. A." në Gjiilan**, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej nga 25 € (njëzetë e pesë-euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë-euro) për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

Rriedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 30.10.2023, ka ngritur aktakuzën me numra PP.II.nr.../2023, të datës 30.10.2023, kundër të akuzuarit A. Q. nga Gjiilani, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 paragrafi 4 me paragrafi 2 të KPRK-ës.

Me datë 15.02.2024, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Adnan Hajdari, i pandehuri A. Q., si dhe mbrojtësi i të pandehurit sipas DZ av.H. A., në të cilën seancë, i pandehuri pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj veprë penale dhe është pënduar për këtë që ka ndodhur, por deri te kjo ka ardhur për shkak të një mosmarrëveshje e rastësishme dhe më të dëmtuarin janë pajtuar, ndërsa i premton gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris këtë vepër apo vepër tjetër penale duke kërkuar që ti shqiptohet një dënim më i butë, andaj gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPP-ës, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit dhe rrjedhimisht shqyrtimi fillestar ka vazhduar me deklaratimet e palëve lidhur me dënimin.

Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve për veprën penale për të cilën akuzohen ngase ka

konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve nuk është kundërshtuar as nga ana e palëve prezentë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të akuzuarit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarve, se të akuzuarit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: inicimi i rastit penal me numër të rastit 2023-CA-..... të dt.25.10.2023, deklaratat e të pandehurit A. Q., deklaratat e të dëmtuarit E. I., deklarata e dëshmitares F. J., vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të sendit i dt.17.10.2023, fotografi të briskut të sekuestruar, brisku i sekuestruar, raporti i oficerit A. M. i dt.13.10.2023 si dhe shkresat e tjera të lëndës. Me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmbajnë asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri A.Q, e ka kryer veprën penale kanosje nga neni 181 paragrafi 4 me paragrafi 2 të KPRK-së, si në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës, shkallën e përgjegjësisë penale në të cilën përfshihet fakti se të njëjtit kanë qenë plotësisht të përgjegjshëm për veprimet e tyre meqenëse të njëjtit në kohën e kryerjes së veprave penale nuk ka lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se të njëjtit kanë paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ti kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor si dhe faktin se të njëjtit këto vepra i kanë kryer me dashje dhe atë direket, po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh edhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve si dhe rrethanat personale të tyre.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës, ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurit gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e tij meqenëse i njëjti fajësinë për kryerjen e kësaj vepre e ka bërë në çdo fazë të procedurës penale, pendimin e tij të cilin gjykata e mori si pendim real, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës del se i pandehuri këtë vepër penale e ka kryer me dashje dhe atë direket sepse e ka ditur se me veprimet e tija do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj i njëjti e ka

dëshiruar përkatësisht kanë ndërmarrë veprime për shkaktimin e pasojës së ndaluar ashtu siç përshkruhet më lartë, po ashtu edhe nga provat e çështjes del se i njëjti ka qenë i vendosur për të kryer veprën penale, andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 72 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor të paraparë si në nenin 73 të KPRK-ës, gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës, të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi konfiskimin

Gjykata ndaj të akuzuarit ka konfiskuar një brisk të zi, me teh 7 cm, e cila do të shkatërrohen pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë.

Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike

Sa i përket kërkesës pasurore juridike Gjykata në bazë të nenit 462 paragrafi 1 dhe 2 për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarin e lartcekur e udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-ës, ka vendosur që të pandehurit ti detyrojë që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 25 € (njëzetë e pesë - euro) si dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë-euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

P.nr.768/2023, me datë 12.03.2024

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.